



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:115905
Datë: 14.10.2024
Numri i dokumentit: 06291363

2024:228829

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetaren e trupit gjykues Fitore Daci, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Lavdije Brahimi Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit A.B me vendbanim në rrugën numër Komuna Shtime, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, paragrafi 1, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.I.Nr.42/24, të datës 20.08.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit A.B si dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare, Av.Jakup Ramadani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 26.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.B, i lindur me datë në Prishtinë, nga babai dhe nëna, e gjinisë me vendbanim në rrugën, numër, Komuna Shtime, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal.....

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se me datën 18.02.2024, rreth orës 19:45, në rr.“..... ” në Shtime, në veturën e tipit ngjyrë të me targa, ka poseduar pa autorizim, me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substancë narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e policisë në veturë janë gjetur një qese najloni me 10 njësi të substancës narkotike të llojit marihuanë me peshë Neto 9.57 gram, një grinder (mulli për bluarje të marihuanës) dhe një pako rizlla (letra për mbështjellje të marihuanës) të cilat janë sekuestruar nga policia.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, paragrafi 1, të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72, të KPRK-së, si dhe neneve 364 , 449, të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind euro), të cilën gjobë i njëjti obligohet të e paguaj në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë, si dhe

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri brenda periudhës kohore prej 2(dy)viteve, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të e paguajë gjobën, atëherë konform nenit 43 paragrafi 4, të KPRK-se, gjykata do të ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20€/ njëzet euro/të pa paguara, do e vuaj një ditë burgim.

Konform nenit 267 paragrafi 5, të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme neto 9.57 gram.

Konform nenit 276 paragrafi 2.2.6 të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme një grinder (mulli për bluarje të marihuanës) dhe një pako rizlla (letra për mbështjellje të marihuanës).

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe të paguaj shumën prej 50 €(pesëdhjetë euro), në emër të Fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15(pesëmbëdhjetë)ditëve, nga data kur Aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria e Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP.I.Nr.42/24, të datës 20.08.2024, ka ngarkuar të pandehurin A.B, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1, të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.09.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Valdet Avdiu, i pandehuri A.B dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Jakup Ramadani.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar

Në shqyrtimin fillestar të datës 26.09.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 paragrafi 1të KPPK-së dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 241 paragrafi 4, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri A.B me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, është penduar thellë, kërkon falje publike, është hera e parë që bien ndesh me ligjin, deklaron se deri para pak kohe ka qenë i varur nga substancat narkotike, ka konsumuar edhe vetë, ndërsa tani më nuk e konsumon e ndjen veten shumë mirë që ka arritur të largohet nga varësia e substancës, më nuk është duke e konsumuar as për vete, i vjen keq që ka kryer këtë vepër penale dhe i premtom gjykatës se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale si dhe e lutë gjykatën që të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjyqtarja në kuptim të nenit 242 paragrafi 5, të KPPK-së, ka kërkuar që prokurori i shtetit dhe mbrojtësi të japin pikëpamjen e tyre lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, lidhur me mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqë i njëjti pranim është bërë në pajtim me nenin 242, të KPPK-së. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Gjykatës i propozon që me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese dhe ato rënduese, sidomos ato që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale. Ashtu që të njëjtit ti shqiptohet një dënim alternativ pasi që është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe beson që me shqiptimin e një dënimi të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Jakup Ramadani, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij si dhe e akcepton në tërësi propozimin e prokurorit të shtetit mbi shqiptimin e një mase më të butë dhe atë dënim me gjobë pasi që i akuzuari i tij e arsyetoj qëllimin e kryerjes së kësaj veprë penale duke marrë parasysh pranimin e fajësisë, se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe se është i moshë së re, ka filluar të punojë që dy muaj në një punë të rregullte dhe shpreson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i caktuar dhe se në të ardhmen beson dhe shpreson në deklaratën e tij se nuk do të ndeshet më asnjëherë me ligjin.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 paragrafi 6, të KPPK-së, edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurit për nenin 246 paragrafi 1, të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si: raporti i oficerit i datës, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës, raporti i testit fushor i datës si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, Kryetarja e trupit gjykues, konform nenit 242 paragrafit 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të të pandehurit

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1, të KPRK-së sepse i njëjti në kundërshtim me ligjin ka poseduar ka poseduar pa autorizim, me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substancë narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e policisë në veturë janë gjetur një qese najloni me 10 njësi të substancës narkotike të llojit marihuanë me peshë Neto 9.57 gram, një grinder (mulli për bluarje të marihuanës) dhe një pako rizlla (letra për mbështjellje të marihuanës) të cilat janë sekuestruar nga policia.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i pandehuri është penduar për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris, shpreh keqardhje për ngjarjen e ndodhur dhe se i njëjti nuk është i njohur si kryerës i veprave penale, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese dhe të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konfiskimi dhe shpenzimet procedurale

Vendimi për konfiskim e substancës narkotike është marrë në konformitet me nenin 267 paragrafi 5 dhe nenin 276 paragrafi 2.2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1, lidhur me nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6, të KPPRK-së.

Vendimin për kompensimin e Viktimave të Krimit, është marrë konformitet me nenin 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.2, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit 08/I-109.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
2024:228829, datë 11.10.2024**

Bashkëpunëtorë Profesionale

Lavdiye Brahim Aliu

Kryetarja e trupit gjykues

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.